



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Janar 2021

Nr: 13

VENDIM

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE NR. 32, DATË 16.12.2020 “PËR CAKTIMIN E NJËSIVE
ADMINISTRATIVE KU DO TË KRIJOHEN SELITË E KOMISIONEVE TË ZONAVE
TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25
PRILL 2021”**

Bazuar në nenin 19, paragrafin 1, shkronjat “b” dhe “n”, paragrafin 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Njësitë administrative ku do të krijohen Selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16 dhjetor 2020 “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, sipas lidhjes 1 të tij.

Kryetarët e Bashkive, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi, sigurojnë infrastrukturën logjistike, ambientin dhe mjetet e punës, për krijimin e Selive të KZAZ-ve.

Kryetari i Bashkisë Fier me shkresën nr.38/1 prot., datë 05.01.2021, Kryetari i Bashkisë Berat me shkresën nr.98 prot., datë 08.01.2021, Kryetari i Bashkisë Dropull me shkresën nr.105 prot., datë 08.01.2021, dhe Kryetari i Bashkisë Finiq me shkresën nr.1991/1 prot., datë 27.12.2020, kanë informuar KQZ-në:



Data: 25 Janar 2021
Nr.

Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16.12.2020 “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”

- a) Në njësitë administrative të përcaktuara për krijimin e Selive të KZAZ-ve, njësia administrative Levan për Selinë e KZAZ-së nr. 57, njësia administrative Mbrostar për Selinë e KZAZ-së nr. 58, njësia administrative Otlak për Selinë e KZAZ-së nr. 66, njësia administrative Jorgucat për Selinë e KZAZ-së nr. 82, njësia administrative Dermish për Selinë e KZAZ-së nr. 91, ndërtesat/ambientet që mund të vihen në dispozicion nuk ofrojnë kushte optimale për punën dhe veprimtarinë e KZAZ.
- b) Në vlerësim të mundësive për krijimin e infrastrukturës mbështetëse logjistike për krijimin e Selive të KZAZ-ve nr. 57, nr. 58, nr. 66, nr. 82 dhe nr. 91, kanë propozuar që Selia e KZAZ-së nr. 57, dhe Selia e KZAZ-së nr. 58, të krijohen në njësinë administrative Fier (qytet), Selia e KZAZ-së nr. 66 të krijohet në njësinë administrative Berat (qytet), Selia e KZAZ-së nr. 82, të krijohet në njësinë administrative Grapsh, Bashkia Dropull, dhe Selia e KZAZ-së nr. 91, të krijohet në njësinë administrative Livadhja, Bashkia Finiq.

Referuar detyrave të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor, të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 15 të Vendimit nr.5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, njësitë administrative të propozuara për krijimin e Selive të KZAZ-ve nr. 57, nr. 58, nr. 66, nr. 82, dhe nr. 91, ofrojnë barazlargësi nga qendrat e votimit të ZAZ-ve respektive, si dhe lehtësi logjistike të transportit rrugor.

Referuar përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencën të ndryshojë pjesërisht aktin e nxjerrë prej tij në ushtrim të kompetencave të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “b” dhe “n”, paragrafi 2, të Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16 dhjetor 2020 “Për caktimin e njërive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të



Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, në lidhjen 1 bashkëlidhur, bëhen këto ndyshime:

- a) Selia e KZAZ-së nr.57, krijohet në njësinë administrative Fier (qytet);
 - b) Selia e KZAZ-së nr.58, krijohet në njësinë administrative Fier (qytet);
 - ç) Selia e KZAZ-së nr.66, krijohet në njësinë administrative Berat (qytet);
 - d) Selia e KZAZ-së nr.82, krijohet në njësinë administrative Grapsh;
 - dh) Selia e KZAZ-së nr.91, krijohet në njësinë administrative Livadhja.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

